REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE DHE SHERBIMI SOCIAL

Pustec më 19.02.2026

Nr.250/1 Prot

PROJEKT-VENDIM
Nr.5 Datë 19.02.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 5, DATË 28.01.2026 "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT SOCIAL TË BASHKISË PUSTEC 2026–2030"

Në mbështetje të neneve 18, 24, 54 dhe 55, si dhe nenit 13, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", veçanërisht neni 73, pika 2, shkronja "b", i cili parashikon kompetencat e këshillit bashkiak për miratimin e programeve të strehimit social; Duke u mbështetur në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë fushën e strehimit social, mbrojtjen e shtresave në nevojë dhe garantimin e të drejtës për strehim të përshtatshëm; Duke marrë në konsideratë nevojën për planifikim afatmesëm dhe afatgjatë të politikave vendore të strehimit social, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për familjet dhe individët në nevojë, si dhe garantimin e një qasjeje të drejtë, transparente dhe të qëndrueshme në ofrimin e zgjidhjeve të strehimit. Duke marrë në konsideratë se VKB nr. 5, datë 28.01.2026, nuk u konfirmua në kuadër të kontrollit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Korçë, për shkak të mospërputhjes së një prej kategorive përfituese me përcaktimet e nenit 16 të ligjit nr. 22/2018; Me qëllim harmonizimin e plotë të Programit 5-vjeçar të Strehimit Social 2026–2030 me kuadrin ligjor në fuqi dhe garantimin e ligjshmërisë së akteve të Këshillit Bashkiak; Kryetari i Bashkisë Pustec me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social, i propozon Këshillit të Bashkisë

TË MIRATOJ

1.Programin 5-vjeçar të Strehimit Social të Bashkisë Pustec 2026–2030, miratuar me VKB nr. 5, datë 28.01.2026, bëhen këto ndryshime:

a. Shfuqizohet pika 23 e Tabelës nr. 3 "Programi 5-vjeçar i Strehimit Social", e cila parashikonte si kategori përfituese:
"Familjet të cilave u janë dëmtuar banesat nga tërmeti i datës 21.09.2019 dhe tërmeti i datës 26.11.2019 dhe që nuk janë përfshirë në zonat e shpallura me VKM nr. 750, datë 27.11.2019".
b. Tabela e kategorive përfituese riformulohet dhe harmonizohet në përputhje të plotë me përcaktimet taksative të nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar.

2. Programi 5-vjeçar i Strehimit Social 2026–2030 mbetet në fuqi për pjesët e tjera të tij, të cilat nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse për strehimin social në Bashkinë Pustec për përditësimin e dokumentit të programit dhe zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.Ky projekt vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë Pustec dhe i dërgohet për kontroll ligjshmërie Institucionit të Prefektit, sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

Marjeta Serbin Specialist i NE dhe Strehimit_____
Para Trajko Specialist PAK, drejtat e fëmijeve,_____

KRYETARI I BASHKISË
PALI KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC